

Teuta SHALA-PELI

RAPORTET E GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT ME FAMILJET FISNIKE TË DRISHTIT

Një etapë të rëndësishme në historinë e qytetit mesjetar të Drishtit përbën edhe periudha e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, 1443-1468. Gjatë asaj kohe në Drisht u dalluan një varg figurash historike, të cilat luajtën rol me rëndësi, qoftë në luftë përkrah Skënderbeut ashtu edhe me misionet e tyre si diplomatë të tij. Tashmë është e njohur se qyteti i Drishtit gjatë mesjetës u dallua edhe si seli e familjeve fisnike, të cilat me veprimtarinë dhe kontributin e tyre lanë gjurmë të pashlyera si në jetën politike ashtu edhe në atë kulturore, jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë.

Prandaj, duke iu referuar këtij fakti, në kuadër të këtij punimi do të trajtojmë raportet dhe lidhjet e familjeve fisnike nga Drishti me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, duke u fokusuar te familja Engjëlli, Spani, Suma si dhe te familjet e tjera tek të cilat Skënderbeu gjeti përkrahje dhe mbështetje të pakursyer, madje disa pjesëtarë të këtyre familjeve mbanin funksione dhe pozita të rëndësishme në shërbim të tij. Duhet përmendur faktin se që në fillim, pas kthimit në Shqipëri, Skënderbeun e përkrahën edhe drishtasit. Këtë më së miri e dëshmon pjesëmarrja në Kuvendin e Lezhës (1444) e përfaqësuesve të dy familjeve të njohura nga Drishti, asaj Spani dhe Dushmani.

Të dhënat për raportet e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me familjet fisnike të Drishtit jo rastësisht po i fillojmë me familjen Engjëlli, e cila ishte ndër familjet më të fuqishme fisnike jo vetëm në Drisht, por edhe më gjerë gjatë mesjetës, përkatësisht nga fundi i shek. XIV, për të vazhduar gjatë gjithë shek. XV deri të rënies së Drishtit nën sundimin osman. Nga kjo familje mbi bazën e dokumenteve që disponojmë bëhet e qartë se Pal Engjëlli ishte bashkëpunëtor, diplomat dhe mik i mirë i Skënderbeut. Si diplomat, Pal Engjëlli ka kryer misione diplomatike në cilësinë e ambasadorit të Skënderbeut. Në këtë kontekst, vlen të përmendim, disa nga misionet më të rëndësishme diplomatike të tij, duke filluar nga ai i vitit 1456, kur Pal

Engjëlli ia dërgon kardinalit të Fermos, Domenik Kapranika, një letër të shkruar nga Skënderbeu në Lezhë, e cila mban datën 8 prill 1456, në të cilën kardinali Domenik Kapranika njoftohej lidhur me përgatitjet e ushtrisë turke për një sulm të mundshëm kundër Skënderbeut, duke theksuar se: *“Turku ka bërë përgatitje shumë të mëdha. Thuhet se ai do të marshojë shumë shpesh kundër nesh ose drejt Danubit me 1 400 turq”*, prandaj për t’u mbrojtur nga ndonjë sulm i mundshëm, Skënderbeu kërkonte nga kardinali në fjalë ndihma në njerëz.¹ Si përfaqësues diplomatik i Skënderbeut, Pal Engjëlli ishte aktiv sidomos në vitet e ‘60-ta të shek. XV.

Në këtë drejtim, burime më rëndësi përbëjnë dokumentet e shumta, përkatësisht, përgjigjet që Senati i Venedikut u kthente kërkesave të parashtruara nga ai në emër të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Në cilësinë e ambasadorit, Pal Engjëlli në vitin 1461 e shoqëroi Skënderbeun për në Itali, me rastin e ndihmës që Skënderbeu do t’i ofronte mbretit të Puljes (Apulisë) Ferdinandit.²

Që nga kthimi i tij në Shqipëri, Skënderbeu ishte përballur me sulme të njëpasnjëshme të ushtrisë osmane. I ndodhur vazhdimisht përballë këtij rreziku, Skënderbeu disa herë gjatë viteve të 60-ta të shek. XV, kishte kërkuar nga Republika e Venedikut ndihma të cilat kryesisht ishin të karakterit financiar, mirëpo kishte raste kur kërkoheshin kuaj dhe këmbësorë. Natyrisht se të gjitha këto kërkesa Skënderbeu i kishte bërë nëpërmjet ambasadorit të tij, Pal Engjëllit. Për këtë qëllim, në vitin 1465 Pal Engjëlli si i dërguar i Skënderbeut i kishte parashtruar disa kërkesa Senatit të Venedikut, ku kërkoheshin ndihmë ushtarake, si dhe mjete financiare. Gjithashtu kërkoheshin nga Republika e Venedikut që t’i shkruajë Papës në mënyrë që ky i fundit t’u *bëjë hisenë atë 100 mijë dukate që Shenjëtëria e tij u kishte premtuar si ndihmë atyre që luftojnë kundër turqve*.³

Gjithnjë duke iu referuar përgjigjeve të Senatit të Venedikut lidhur me kërkesat e paraqitura nga Pal Engjëlli, del qartë se gjatë vitit 1466, ky

¹ Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke në shek. XV, Burime dokumentare shqiptare, vëll. I, përgatitur nga Kristo Frashëri, Tiranë 2005, no. 40 (më tej: *Skënderbeu dhe lufta*). *“Turchus ingentissimos fecit apparatus. Ferunt ipsum seu contra nos seu versus Danubium in proximo venturum XIII milia turchorum”*.

² Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, Prishtinë 1982, 395. (më tej: Barleti, *Historia*).

³ Sime Ljubić, *Listine o odnošajih izmedju južnog Slavenstva i Mletačke Republike*, Zagreb: Jugoslavenska akademija znanosti i umjetnosti, (Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium), Knjiga X: od godine 1453-1469 (Zagreb 1891), 334-336 (më tej: Ljubić, *Listine X*); Jovan Radonić, *Duard Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd, 1942, no. 301 (më tej: Radonić, *Duard Kastriot*).

Senat u kishte dhënë përgjigje edhe dy kërkesave të parashtruara nga ai.

Kështu, më 28 prill të vitit 1466, në përgjigjen e Senatit lidhur me kërkesat e Skënderbeut thuhej se: kapitujve që u dorëzuan zotit tonë nga ana e të ndershmit zot kryepeshkopit të Durrësit në emër të Skënderbeut t'u epet kjo përgjigje: së pari, për pikën e parë që kërkon, në bazë të premtimit tonë, që i biri i tij të jetë *komandant i ushtrive tona të atyre anëve dhe vetë ai i madhërishti zot, guvernator. Ne jemi të kënaqur me plotësuar premtimin e dhënë madhërisë së tij, d.m.th. kur të formohet ushtria e njerëzve tonë ndër ato anë, biri i tij do të jetë komandant e ai vetë i madhnueshmi zot do të zgjidhet guvernator*".⁴

Së dyti, në përgjigjen e Senatit thuhej: për të hollat që ai kërkon që t'i dërgoheshin për të paguar rrogat e ushtarëve, kur të grupohen në ushtri, me qëllim që sa më shumë kohë të qëndrojnë nën komandën e tij, t'i përgjigjemi... sikur e lypë puna dhe sikur kemi bërë gjithmonë, me të gjithë provizorët e tjerë, do t'i dërgojmë para herë pas here, që ta plotësojë nevojën atyre njerëzve që ata të rrinë sa më shumë me shkëlqesinë e tij".⁵

Në korrik të po atij viti, përsëri Senati i Venedikut u përgjigjet edhe disa kërkesave të paraqitura nga Pal Engjëlli: më 7 korrik, në mesin e tri kërkesave të Skënderbeut, në njërën prej të cilave kërkohej ndihmë në mjete financiare, Senati kishte kthyer këtë përgjigje: *Ne e shohim me sy të mirë atë të ndërrueshmin ambasador të të madhnueshmit zotnis së tij, të cilin e nderojmë dhe e duam sinqerisht, dhe jemi e do të jemi gjithmonë të gatshëm me ba çdo gja për nderin e të mirën e tij... Por që të kthehemi në çështjen e të hollave, thoni se me gjithë se jemi të ngarkuar sikur thamë më sipër, me shpenzime të rëndësishme, asgjë mangu me ia ba qefin atij zotnije, do të përpiqemi që tani t'i mbledhim 2 000 dukate gjithashtu edhe 1 000 dukate të tjera do t'ia dërgojmë me anë të provizorit tonë. Për këtë arsye lusim e këshillojmë madhështinë e tij që të nxisë trimin e tij të zakonshëm e shpirtmadhësinë e tij dhe të gjitha forcat për me ripushtue çka mundej dhe me damtue sa ma shumë armikun tonë të përbashkët...*"⁶

⁴ Ljubić, *Listine X*, 362-364; Radonić, *Duard Kastriot*, no. 316: "...quo petit, sicut alias sibi promissimus, quod filius suus sit capitaneus gentium nostrarum illarum partium, ipse vero magnificus dominus gubernator...".

⁵ Ljubić, *Listine X*, 362-364; Radonić, *Duard Kastriot*, no. 316.

⁶ Ljubić, *Listine X*, 372; Radonić, *Duard Kastriot*, no. 332: "...sed ut redeamus ad factum pecuniarum, dicimus, quod quamquam, sicut prefertur, gravatissimi sumus multis modis expensis importabilibus, tamen in complacentiam illius domini conabimur de presenti sibi dari facere hic ducatos II mille et alios mille ducatos sibi dari mandabimus per provisorum nostrum Albanie. Quamobrem hortamur et rogamus magnificenciam suam, quod excitare

Një vit më vonë (1467), përkatësisht gjatë muajit mars 1467, Pal Engjëlli në cilësinë e ambasadorit të Skënderbeut qëndroi në Republikën e Venedikut. Kësaj here kishte kërkuar që t'i paguhet provizioni Skënderbeut. Fjala është për një vendim të Senatit lëshuar më 20 mars 1467, ku thuhej se: *"... i madhërishmi zot Skënderbe na është lutë vazhdimisht më anë të ambasadorit të tij që na të pranojmë me i dhënë provizionin e vitit të kaluar që ka mbetë pa marrë. Gjithashtu edhe provizionin e këtij viti që të mundet të përballojë rreziqet që tani ai ka..."*. Sipas vendimit në fjalë lidhur me këtë kërkesë, Senati merr vendim: *"... që nga çdo vend e zyre t'i epen atij zotnije 2 000 dukate duke i vënë këto në hesap të provizionit të tij, si të vitit të kaluar si të këtij viti..."*.⁷

Në të njëjtin vit, Pal Engjëllin e gjejmë përsëri në Venedik, së bashku me djalin e Skënderbeut, ku ia paraqet Republikës së Venedikut tetë kërkesa. Nga përgjigjja e Senatit të Venedikut, më 26 tetor 1467, del se nga tetë kërkesat e paraqitura nga ambasadori i Skënderbeut, Pal Engjëlli, në të parën kërkohej që t'i dërgoheshin kuaj dhe këmbësorë në bazë të një premtimit të bërë nga ana e Venedikut: *"... Për sa i përket kërkesës së parë rreth kuajve, thoni se për shkak të kohës së dimrit dhe për shumë vështirësi të tjera, nuk mund të gjendet asnjë burrë i armatosur, që tani pranon me shkuar ndër ato anë. Këtë gjë i ndërrueshmi zot e kryepeshkop e pa me sytë e vet dhe e mori vesh nga vetë njerëzit e armatosur. Por sa të vij pranvera do të marrim masa brenda mundësive tona me kënaqë kërkesat e madhështisë suaj. Për sa i përket dërgimit të këmbësorëve, balistarëve e pushkatarëve, thoni se me gjithë kohën e përshtatshme do të përpigemi për tani me dërguar 400 këmbësorë për të kënaq madhështinë e tij, dhe të tjerë do të dërgojmë sa të vijë pranvera, si ta kërkojnë gjendja dhe koha."*⁸

Krahas misionit të tij si diplomat, Pal Engjëlli po ashtu ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në krijimin e marrëdhënieve të mira midis Skënderbeut dhe princërve shqiptarë. Në këtë aspekt vlen të përmendim se në vitin 1452, Pal Engjëlli ngarkohet prej Papës Nikolla V për të pajtuar Skënderbeun me

velit solitam virtutem et magnanimitatem suam et cunctis eius viribus attendere ad recuperationem rerum suarum et ad damna perfidy comunis hostis...".

⁷ Ljubić, *Listine X*, 387-388; Radonić, *Duarđ Kastriot*, no. 351: *"... quod de omni loco et officio dari debeant eidem domino ducati duomille ponendi ad computum eiusdem provisionis sue tam anni preteriti quam presentis..."*.

⁸ Ljubić, *Listine X*, 399-400; Radonić, *Duarđ Kastriot*, no. 380: *"1467. XXVI octobris. Misit ad nostrum dominium magnificus dominus Scandarbegus filium suum nec non reverendissimum archiepiscopum dirachiensem supplicatum, ut equos peditesque iuxta promissionem nostram sibi mittere velimus etc..."*.

Dukagjinët.⁹

Krahas kontributit të lartpërmendur, Pal Engjëlli në të njëjtën kohë ishte edhe mik i ngushtë i Skënderbeut. Këtë Skënderbeu e shpreh haptas në letrën dërguar kardinalit të Fermos, Domeniko Kapranika, më 8 prill 1456, ku ndër të tjera i thotë se zoti Pal Engjëlli, prurësi i kësaj letre, është miku im më i mirë, prandaj këtë “*ia rekomandoj zotërisë suaj të përmendur që ta trajtoni sa më mirë që të jetë e mundur*”.¹⁰

Autoriteti dhe respekti që Pal Engjëlli gëzonte nga Skënderbeu vërehen edhe në udhëzimet e porositë që ai i lë birit të tij, Gjonit.¹¹ Gjatë viteve 1464-1467, Shqipëria u përball me sulme të njëpasnjëshme të ushtrisë osmane. Gjatë atyre viteve, të cilat njëkohësisht shënojnë edhe fazën e fundit të luftës kundërosmane të udhëhequr nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, përkrahë Skënderbeut u ndodhën edhe Pjetër Engjëlli vëllai i Pal Engjëllit, njërit nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Skënderbeut, si dhe Dhimitër Frangu. Në vitin 1464, në një betejë të zhvilluar pranë Ohrit¹² kundër forcave osmane, Skënderbeu në mesin e kapitenëve të cilët duhej t’u prinin pesëqind kalorësve kishte caktuar edhe Pjetër Engjëllin.¹³ Ndërsa, Dhimitër Frangu, kushëri i Pal Engjëllit,¹⁴ thuhet se ka shërbyer pranë

⁹ Daniele Farlato; Jacobo Coletto, et. al. *Illyrici Sacri*, vëll. VII, Venetiis 1817, 93, 241; Fan Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*, Tiranë 1967, 109.

¹⁰ *Skënderbeu dhe lufta*, no.40: “... *Latore praesentium domino Paulo Angelo familiarissime utor hunc maiorem in modum Reverendissime domine Vester comendo...*”.

¹¹ Dhimitër Frangu, *Komentari i luftërave të turqve kundër Skënderbeut*, Globus-R, Tiranë 2000, 63.

¹² Sipas Marin Barletit kjo betejë është zhvilluar më 14 gusht 1464. Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, Faik Konica, Prishtinë, 2001, shih faqe 597, fusnota b. (Më tej: Barleti, *Historia e jetës*); *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke e shekullit XV*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1967, 82; Dhimitër Shuteriqi, “Dhimitër Frëngu (1443-1525)”, *Studime për Epokën e Skënderbeut* 3, Tiranë 1989, 306-307.

¹³ Barleti, *Historia e jetës*, 597: “... Në krye të këtyre ai vuri Pjekun e Manuelit dhe Pjetër Engjëllin prej Drishtit, të birin e Andreas, burra të dëgjuar si për nga soji, si për nga veprat. Skënderbeu i dërgoi këta përpara me qëllim që po të mundnin ta ngacmonin armikun të dilte dhe të përleshje me ta...”. Frangu, *Komentari i luftërave*, 50; *Skënderbeu dhe lufta shqiptaro*, 344: “... Skënderbeu thirri Pekë Emanuelin dhe Pjetër Engjëllin, vëllain e kryepeshkopit Pal, të cilët i caktoi kapitenë të pesëqind kalorësve të përzgjedhur, duke i porositur që duhet të shkonin shpejt pranë qytetit të Ohrit dhe të provokonin turqit që t’i sulmonin. Dhe kur turqit t’i sulmonin të ktheheshin, duke u shtirë sikur po ia mbathnin prej tyre dhe t’i shpinin drejt vendit ku Skënderbeu do t’i zinte në mes dhe të arrinte qëllimin e tij”.

¹⁴ *Skënderbeu dhe lufta*, 344; Shuteriqi, “Dhimitër Frëngu (1443-1525)”, 307.

Skënderbeut si funksionar për financa që nga viti 1466.¹⁵ Po ashtu, ai më 1466-67, kishte shoqëruar Skënderbeun gjatë udhëtimit që bëri në Romë dhe Napoli,¹⁶ për të kërkuar ndihmë. Mbi bazën e të dhënave dokumentare Skënderbeu kishte arritur në Romë më 12 dhjetor 1466,¹⁷ dhe ishte kthyer në Shqipëri në fillim të prillit 1467.¹⁸

Një familje tjetër e njohur nga Drishti për të cilën dokumentet e kohës dëshmojnë për raporte të mira me Skënderbeun është edhe familja Spani. Raportet e mira me këtë familje vërehen që nga kthimi i Skënderbeut në Shqipëri, ku si shumë familje tjera fisnike shqiptare të asaj kohe që e përkrahën Skënderbeun, edhe familja Spani veproi në një mënyrë të tillë. Përkrahja e parë e tyre erdhi me pjesëmarrjen në Kuvendin e Lezhës, të thirrur nga Skënderbeu, më 2 mars të vitit 1444, në të cilin mori pjesë Pjetër Spani¹⁹, së bashku me djemtë e tij: Bozhidarin, Aleksin dhe Hervojen.²⁰

Për raporte miqësore të familjes Spani me Skënderbeun dëshmon edhe rekomandimi që Skënderbeu në vitin 1466 i kishte bërë Republikës së Venedikut që të priste e të mbronte djemtë e Pjetër Spanit. Kjo e fundit pohonte se: “... *sa i përket bijve të të ndjerit Pjetër Spani, thoni atij zotnije, pranojmë me i marrë nën mbrojtjen tonë dhe me i pas gjithmonë për zemër,*

¹⁵ Frangu, *Komentari i luftërave*, 4.

¹⁶ Shuteriqi, “Dhimitër Frëngu (1443-1525)”, 307.

¹⁷ “Radonić, *Dužd Kastriot*, no. 340: “*El Signor Scandarbeo gionse qui veneri (=12 decembre) et incontra li forono mandate le famiglie de cardinali.*”.

¹⁸ Skënderbeu dhe lufta, 166.

¹⁹ Theodor Ippen, “Dy shekell e gjysmë nga historia e Shqipërisë, 1204-1444. Princërit e Janinës”, *Dituria nr.12*, Tiranë 1927-28, 384 (më tej: Ippen, “Dy shekell e gjysmë”). Branislav Millutinoviç, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike*, 1985/15, Prishtinë 1985, 59 (më tej: Millutinoviç, “Drishti nën sundimin”); Aleks Buda, *Studime për Skënderbeun*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë 2018, 127 (më tej: Buda, *Studime për Skënderbeun*).

²⁰ Jireček, “Skutari”, 113. Në burimet dhe literaturën që i kemi në dispozicion për familjen Spani kemi ndeshur në disa anëtarë të kësaj familjeje me emrin Pjetër Spani. Në këtë rast, fjala është për Pjetër Spanin i cili kishte tre djem: Bozhidarin, Aleksin, (*Alexius filius Petri Spani*) dhe Hervojën. (Nicolae Jorga, *Notes et extraits pour servir à l'histoire des croisades au XVe siècle*, Volume III, Paris: Ernest Leroux, Bucurest: l'Academie Roumaine, 1899, 384 (më tej: “Jorga, *Notes et extraits*”): “*Petrus Span, Albanensis*”; Constantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, L. Thalloszy, *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Band I, München und Leipzig, 1916, 113 (më tej: Jireček, “Skutari”): “... *Erhattedrei Söhne : Božidar, Alexius filius Petri Spani ..., und Hrvoje ...*”; Константин Јиречек, *Историја Срба*, Прва књига до 1537. Године Културна историја “Научна књига” Космајска 28 Београд 1952, 390 (më tej: Jireček, *Историја Срба прва књига*).

dhe do të jemi gjithnjë të gatshëm për dobinë e tyre...”.²¹ Në dokumente të kohës si bashkëpunëtor i Skënderbeut përmendet edhe Marin Spani, një figurë tjetër e njohur nga kjo familje, i cili që nga fillimi ishte një nga gjeneralët më të mirë të Skënderbeut,²² madje Skënderbeu Marin Spanin e kishte zgjedhur që të kujdesej për qytetin e ri të Balcit.²³ Për më tepër, familja Spani kishte edhe lidhje familjare me familjen Kastrioti, në rastin konkret më Skënderbeun, ngase gruaja e Pjetër Spanit ishte motra e Vojsavës nënës së Skënderbeut.²⁴

Në mesjetë martesat ishin një element i rëndësishëm që ndikonin në lidhjet apo raportet në mes të familjeve të njohura [me ndikim] të asaj kohe jo vetëm në Shqipëri, por edhe me vendet tjera. Duke iu referuar gjenealogjive të studiuesve, A. Degrand, Du Cange dhe Carl Hopf, në të cilat prezantohet trangu familjar i familjes Spani, del qartë se Pjetër Spani të cilin shpeshherë e ndeshim edhe me emrin Michael (Mikel), ishte i martuar me Agnese. Në gjenealogjinë e Carl Hopf dhe A. Degrand thuhet se ai ishte i martuar me Agnes Tribalda nga Pollogu.²⁵ Ndërsa, në gjenealogjinë e Du Cange, thuhet se gruaja e tij [Pjetër Spanit] ishte Agnes, vajza e zotit të Pollogut, motra e Voisaves.²⁶ Si bashkëpunëtorë dhe përkrahës të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut përmenden edhe pjesëtarë të familjes Suma, në veçanti duhet veçuar rolin e ipeshkvit Andrea Suma, i cili përmendet në mesin e personave që ishin të pranishëm përkrah Skënderbeut me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së paqes mes Skënderbeut dhe Republikës së Venedikut, më 4 tetor 1448.²⁷ Përveç kësaj, në bazë të një

²¹ Ljubić, *Listine X*, 372; Radonić, *Dužd Kastriot*, no. 332

²² Hashorva, *Bashkëluftetarët*, 121.

²³ Marin Barleti, *Historia*, 152.

²⁴ Charles du Fresne Du Cange, *Historia Byzantina duplici commentario illustrata: Prior familias ... Imperatorum Constantinopol. ... complectitur alter descriptionem urbis Constantinopolis*, Paris: Louis Billaine, 1680, [351] (më tej: Du Cange, *Historia*).

²⁵ A. Degrand, *Souvenirs de la Haute Albanie*, Paris 1901, [316] (më tej: Degrand, *Souvenirs*): “... Ep.: Agnès Tripalda de Bologne”; Hopf, *Chroniques*, 535: “... Agnese Tripalda de Pologi...”.

²⁶ Du Cange, *Historia*, 351: “...Huic I. uxor fuit Agnes, Pologi domini filia, Voifavæ Magni Scanderbegi foror. 2. uxor N. Vide Gefa Scanderbegi..., I. Andreas Spanus Dux & Comes Drivaftenfis, uxor ducit Agnetem Arianitæ Comneni filiam. Abeoprognotos Angelos quidam volunt, quorum Stemma supra contexuimus. 2. “Alexius Spanus, ux. Milizza, filia Georgii Brankovitzii Serviaë Despotæ. 2. Petrus. 2. Paulus. 2. Michael. 2. Joannes. 2. Hernon. 2. Martinus. 2. Agnes...””; Theoharis Stavrides, *The Sultan of vezirs: the life and times of the Ottoman Grand Vezir Mahmud Pasha Angelović (1453-1474)*, 229, Leiden-Boston-Köln 2001.

²⁷ Ljubić, *Listine IX*, 282-283; Radonić, *Dužd Kastriot*, no. 22.

procesverbali të mbajtur në Raguzë më 18 mars 1452, vërtetohej se ambasadorit të Skënderbeut ipeshkvit Andrea Suma, i ish-in dhënë gjithsejtë 4 893 dukatë ari, sa i përkisnin Skënderbeut, si të holla të tij, duke theksuar se këtë shumë duhet ta marrë në bazë të koncesionit të bërë nga Selia Apolistike.²⁸ Pra me nismën, e Selisë Apostolike ish-in grumbulluar si ndihmë për luftën e shqiptarëve kundër ushtrive osmane.

Këto nuk ishin familjet e vetme drishtase për të cilat dokumentet e kohës dëshmojnë për raportet dhe mbështetjen që i ofruan Skënderbeut. Në bazë të dhënave që posedojmë, Skënderbeu kishte përkrahje edhe nga familja Dushmani, ku pjesëtar i kësaj familjeje, Lekë Dushmani, merr pjesë në Kuvendin e Lezhës.²⁹ Gjithashtu duhet veçuar edhe kontributin e familjes Moneta, përkatësisht Nikollë Monetës, i cili në vitin 1466 u shqua përkrah Skënderbeut në luftë kundër Ballaban Pashës.³⁰ Në këtë luftë, Skënderbeu ia kishte besuar Nikollë Monetës udhëheqjen e një pjese të ushtrisë së tij.³¹

Edhe përkundër raporteve të mira që Gjergj Kastrioti-Skënderbeu kishte krijuar me drishtasit, megjithatë në dokumente përmenden individë të caktuar nga Drishti, të cilët në kohë dhe momente të caktuara për qëllime personale nuk i qëndruan besnik apo thënë më mirë, nuk e përkrahën Skënderbeun. Ndonëse individuale, nuk munguan raste kur drishtasit mbajtën anën e kundërshtarëve të Skënderbeut. Një rast i tillë përmendet në një dokument të vitit 1448, ku thuhet se drishtasi Nikollë Suma kishte mbajtur anën e Venedikut në luftën e tij me Skënderbeun dhe si shpërblim për këtë, Senati e emëron si llogaritar me pagesë për regjistrimin e të ardhurave që i vinin manastirit të Shën Gjonit nga e dhjeta e drithit, e verës dhe e vajit.³² Edhe pse më lart folëm për raporte miqësore mes Skënderbeut

²⁸ Radonić, *Duard Kastriot*, no. 51; *Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke*, no. 30; Gjon Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në sfondin e Arkivit të Dubrovnikut*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 2018, no. CXV: “*permissse et concesse in ciuitate Ragusii thmtibus et consignantibus inter ducatos et monetas et raubas ipperperos quatuor mille octingentes nonaginta tres ipsi domino Scandarbecho spectantes, pertinentes et ipsum tangentes, extractis expensis necessario factis, pro integra solutione sue medietatis, quam ex concessione facta a sede apostolica...*”.

²⁹ Ippen, “Dy shekell e gjysmë”, 384; Millutinoviç, “Drishti nën sundimin”, 59; Buda, *Studime për Skënderbeun*, 127.

³⁰ Barleti, *Historia e jetës*, 476.

³¹ Frangu, *Komentar i luftërave*, 59.

³² Giuseppe [Josephi] Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, 25 vol., Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1967-1972 (më tej: AAV), AAV, p. III, t. 20, no. 5444, 91; Oliver Jenès Schmitt, “Marrëdhëniet e

dhe familjeve Spani e Dushmani, megjithatë në vitin 1447, nën ndikimin e Venedikut, Pjetër Spani dhe Lekë Dushmani që të dy pjesëmarrës në Kuvendin e Lezhës, u shkëputën prej Lidhje së Lezhës.³³ Megjithatë raste të tilla ishin individuale dhe nuk përfaqësonin qëndrimin e familjeve të cilave u përkisnin.

Siç shihet, të dhënat e lartpërmendura janë tregues i mirë se familjet fisnike drishtase i dhanë një mbështetje të fuqishme çështjeve të rëndësishme që ndërlidhen me epokën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, duke u bërë pjesë e pandashme e tyre, duke filluar nga angazhimi i tyre në misione diplomatike siç kemi rastin e Pal Engjëllit dhe Andrea Sumës të cilët si ambasadorë të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, u dalluan në misionet e tyre me Republikën e Venedikut dhe Raguzën, qofshin ato të natyrës politike, ekonomike po ashtu në raste të caktuara duke kërkuar ndihma ushtarake, si dhe kërkesa tjera të cilat ndërlidheshin më përgatitjet për luftë kundër ushtrive osmane. Përveç shërbimeve diplomatike, figura të njohura nga Drishti u shquan edhe si udhëheqës ushtarakë, siç kemi rastin e Marin Spanit, i cili ishte një nga gjeneralët më të mirë të Skënderbeut, pastaj Nikollë Moneta, i cili luftoi përkrah Skënderbeut në luftë kundër Ballaban Pashës, si dhe Pjetër Engjëlli, i cili u dallua në betejën e zhvilluar afër Ohrit.

Venedikut me kishat para dhe gjatë luftës shqiptaro-osmane, roli i tyre dhe depërtimi i humanizmit në Shqipëri, *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë 2003, 10.

³³ Barleti, *Historia*, 142; Millutinoviq, "Drishti nën sundimin", 59; Buda, *Studime për Skënderbeun*, 133.

SUMMARY

Teuta SHALA-PELI

THE RELATIONS BETWEEN GEORGE CASTRIOTA SKANDERBEG AND NOBLE FAMILIES OF DRISHTI

The city of Drishti was known as a seat of prominent medieval feudal families, which through their activities and input left indelible traces in political and cultural life not only in Albania but also beyond. Therefore, referring to this fact this paper elaborates the relations and links of noble families of Drishti with George Castriota Skanderbeg, focusing on families of Engjelli, Spani, Suma, Moneta and Dushmani.

Consequently, the attention was addressed towards certain individuals who in the capacity of partners, advisers and diplomats of Skanderbeg, were a model that proved the support Skanderbeg received from the noble families of Drishti. For example, Pal Engjell and Andrea Suma – ambassadors of Skanderbeg, were distinguished through their missions in the Republic of Venice and Ragusa, regardless if they were of a political or economic basis, or in certain cases seeking military assistance or other requirements related to the preparation for a war against the Ottoman armies. In addition to diplomatic services, the well-known personalities of Drishti were distinguished as military commanders. Marin Spani was one of the best generals of Skanderbeg; Nikolle Moneta fought alongside the Skanderbeg against BallabanPasa, or PjeterEngjelli that was distinguished in the battle near Ohrid.